



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 31 gusht 2012
Nr. ref.: RK288/12

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rasti nr. KI125/10

Parashtruesi

Sofije Grabovci

**Vlerësim kushtetues i vendimeve
të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, AC. Nr. 440/07, i 17 dhjetorit 2008,
dhe
të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. I. nr. 41/2008, i 13 gushtit 2010**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Ivan Čukalović, gjyqtar dhe

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues është Sofije Grabovci nga Gjilani.

Vendimi i kontestuar dhe objekti i çështjes

2. Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, AC. Nr. 440/07, i 17 dhjetorit 2008, dhe Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. I. nr. 41/2008, i 13 gushtit 2010.

Baza juridike

3. Neni 113.7 i Kushtetutës, neni 20 i Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Ligji), dhe rregulli 56 (2) i Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës.

Procedura në Gjykatë

4. Parashtruesja e parashtrroi kërkesën në Sekretariatit e Gjykatës Kushtetuese më 13 dhjetor 2010.
5. Me urdhrin e Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese, të 16 dhjetorit 2010, gjyqtari Altay Suroy u caktua Gjyqtar raportues. Kryetari e caktoi Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët Almiro Rodrigues (kryesues), Gjyljeta Mushkolaj dhe Iliriana Islami.

Përmbledhja e fakteve siç pohohen nga parashtruesi

6. Parashtruesja filloi të punonte në atë që tani quhet Raiffeisen Bank më 14 tetor 2002. Ajo tha që banka kishte kërkuar që ajo të jepte dorëheqje për shkak të parregullsive që u dolën nga një auditim i kryer nga banka më 20 maj 2005. Ajo pohon që nënshkroi dorëheqjen gjersa vuante nga një gjendje mjekësore që mund të ketë shkaktuar që ajo të lëngonte nga “çrregullimi i kujtesës dhe turrja e vetëdijes”. Parashtruesja ishte në pushim mjekësor dhe ishte e hospitalizuar prej 17 janarit 2005 deri më 28 janar 2005. Bashkëshorti i saj e dorëzoi dorëheqjen e saj me shkrim në bankë më 21 maj 2005.
7. Më pas, parashtruesja konkurroi në bankë që të lejohej të kthehej në punë. Banka iu përgjigj me një letër më 31 gusht 2006, se kërkesa e saj për t’u kthyer në punë nuk ishte pranuar. Banka theksoi se një çështje, që ishte zbuluar dhe hetuar nga auditorët e brendshëm të bankës, konsiderohej shpërdorim i rëndë i detyrës zyrtare dhe që qëndronte prapa konkluzioneve të auditorëve.
8. Parashtruesja inicioi procedurë kundër Raiffeisen Bankës pranë Gjykatës Komunale në Gjilan në vitin 2006, e cila vendosi në favor të saj më 3 shtator 2007. Gjykata Komunale konstatoi që asaj i ishte kërkuar të jepte dorëheqje dhe se ajo dha dorëheqje gjersa ishte në gjendje të rëndë shëndetësore si rrjedhojë e të cilës ajo nuk mund ta kontrollonte sjelljen e vet. Gjykata “pjesërisht i besoi” deklaratës së përfaqësuesit të bankës, i cili tha se asnjë procedurë disiplinore nuk ishte iniciuar kundër parashtrueses për shkak se ajo e kishte ofruar dorëheqjen e vet. Gjykata në mënyrë implicite pranoi që asaj i ishte kërkuar të jepte dorëheqje.
9. Sipas ankesës, Gjykata e Qarkut në Gjilan e anuloi Vendimin e Gjykatës Komunale dhe konstatoi se parashtruesja kishte dhënë dorëheqje vullnetarisht. Ky arsyetim u pranua më pas nga Gjykata Supreme në vendimin e saj të 13 gushtit 2010, në favor të bankës.
10. Parashtruesja e parashtrroi një kërkesë në Gjykatën Kushtetuese më 13 dhjetor 2010 dhe i bashkëngjiti kopjet e të gjitha vendimeve të gjykatave të përmendura bashkë me një sërë dokumentesh dhe raportesh mjekësore. Kërkesa, pa e cekur në mënyrë specifike, duket të jetë kërkesë për anulimin e vendimit përfundimtar të Gjykatës Supreme të Kosovës, të 13 gushtit 2010.

11. Në kërkesë nuk ceket se si janë shkelur të drejtat e saj kushtetuese me vendimin e Gjykatës Supreme, të 13 gushtit 2010. As parashtruesja nuk tregon si ajo gjykatë ka vepruar në mënyrë arbitrare, si nuk i ka marrë parasysh faktet përkatëse, dhe si ka vepruar jashtë kompetencave të veta. Ajo nuk tregon si i ishte mohuar gjykimi i drejtë nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

12. Për të gjykuar për kërkesën e parashtrueses, Gjykata së pari duhet të shqyrtojë nëse parashtruesja i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara në Kushtetutë, dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe Rregullore të punës.
13. Njëri prej kritereve është se parashtruesi nuk mund të ankohet që gjykatat e rregullta kanë bërë lajthim të fakteve ose të ligjit, vetëm dhe nëse ato mund t'i kenë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara me Kushtetutë.
14. Në këtë drejtim, Gjykata Kushtetuese thekson se nuk duhet të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt kur i shqyrton vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Gjykatat e rregullta kanë për detyrë t'i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih, Aktvendimin për papranueshmëri të Gjykatës Kushtetuese në Rastin Nr. KI 13/09, Sevdail Avdyli, të 17 qershorit 2010, dhe *mutatis mutandis*, Garcia Ruiz kundër Spanjës (GC), nr. 30544/96, para. 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut 1999-I).
15. Gjykata Kushtetuese vetëm mund të shqyrtojë nëse dëshmitë janë paraqitur në mënyrë të tillë dhe nëse procedurat në përgjithësi, të shikuara në tërësinë e tyre, janë mbajtur në mënyrë të tillë sa që parashtruesi nuk ka pasur gjykim të drejtë (shih, p.sh., Raportin e Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut në rastin *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, App. Nr. 13071/87, të miratuar më 10 korrik 1991). Prandaj, Gjykata konkludon që kërkesa duhet të hidhet poshtë si, qartazi, e pabazuar.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenit 20 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe Rregullit 56 (2) të Rregullores së punës, njëzëri

VENDOSI

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari Raportues

Altay Suroy



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Prof. dr. Enver Hasani